

Fjala përshëndetëse në Kongresin e Shkencave Humane, Sociale dhe Arteve

Tetovë, 12 Nëntor 2025

***Te nderuar profesorë, studentë e të ftuar,
Mirë se ju gjeta në shtëpinë tuaj të dijes,***

Është nder dhe emocion i veçantë për mua të jem sot në Universitetin e Tetovës. Ky qytet, ky universitet, mbartin më shumë se histori akademike. Janë dëshmi e një beteje për egzistencë, dinjitet dhe dije. Janë fryt i një përpjekjeje që nisi nga nevoja për arsim në gjuhën amtare, por u kthye në simbol të emancipimit kombëtar.

Është nder për ju e të gjithë shqiptarët që kjo sallë mban emrin e Parashqevi e Sevasti Qiriazi, grave që besuan se drita e arsimit është arma më e fuqishme e një kombi.

*“Arsimi e mbron lirinë më mirë se sa një ushtri.” - tha Parashqevia pa e ditur se po linte pas një nga thëniet më filozofike për natyrën e **lirisë, pushtetit dhe dijes**. Armët mund të mbrojnë tokën, por vetëm arsimi mbron **ndërgjegjen kombëtare**.*

Universiteti i Tetovës është vetë dëshmia e kësaj filozofie: ai u ngrit nga vullneti për dije, në kohë kur dija vetë ishte akt guximi.

Ndaj është kënaqësi të jem sot këtu, jo thjesht në një aktivitet universitar, por në një hapësirë të të menduarit. Sepse sot, më shumë se kurrë, kemi nevojë jo për tituj apo shtrëngime duarsh, por për ide. Ide të guximshme, të menduara, edhe pse jo rrallëhere mund të duken si të papërshtatshme.

Kur shoh këtë auditor plot me të rinj e të reja, më kujtohen ditët e para të punës sime si pedagoge në Universitetin e Tiranës. Isha pjesë e grupit të parë të pedagogëve të rinj që i dhanë formën e post komunizmit Fakultetit të Shkencave Sociale. Në epokën komuniste, shkencat që merren me njeriun ishin

robëruar nga ideologjia. Sociologjia, psikologjia dhe filozofia ishin shërbëtore të doktrinės, jo kërkime të së vërtetës.

Ne ishim si ndërtues në një terren të panjohur. Duhej të krijonim gjuhën e re të mendimit shkencor, të përkthenim tekstet që mungonin, të ngjallnim kuriozitet dhe të ishim seriozë edhe pse shumë të rinj për t'ju mësuar studentëve se si të mendosh ndryshe nuk është tradhti, por të argumentosh mendimin tënd në menyrë kritike është pjekuri.

Ky besim më ka ndjekur gjatë gjithë jetës sime profesionale. Nuk ka qenë pa kosto, por I kam pranuar edhe to si kosto të lirisë personale.

Të dashur pjesëmarrës,

Kam kaluar dy dekada duke u marrë me integrimin europian dhe marrëdhëniet mes vendeve tona. Kam parë nga afër se si zgjerimi është shndërruar nga një vizion bashkimi, në një proces kompleks, dhe të kontestuar pa arsye.

Sot, ky kompleksitet është thelluar edhe më shumë nga sfidat e mbrojtjes dhe sigurisë. Lufta në Ukrainë, paqëndrueshmëria globale, dhe nevoja për një Europë më autonome, e kanë kthyer zgjerimin në një imperativ strategjik.

Transformim. Ndryshim. Kjo është ajo më të cilën përballen të gjitha shoqëritë sot.

Në gjysmëshekullin e fundit kemi parë një transformim të thellë ekonomik global. Vendet që dominonin ekonominë botërore në vitet '70 kanë humbur gradualisht ndikimin, ndërsa ekonomitë në zhvillim janë ngritur me një ritëm të shpejtë.

Tani po jetojmë në një periudhë tjetër të shpikjeve të mëdha, intelijenca artificiale, robotika dhe sistemet autonome, të cilat po transformojnë jo vetëm industrinë, por edhe të gjithë strukturat shoqërore. Ashtu si në revolucionet teknologjike të së kaluarës, këto ndryshime sjellin mundësi të jashtëzakonshme, por edhe paqëndrueshmëri të thellë.

Inteligjenca artificiale po trondit tregjet e punës dhe po riformëson mënyrën e marrjes së vendimeve, ngjashëm me kalimet e mëparshme nga bujqësia në industri.

Tranzicioni energjetik po zhvendos fuqinë gjeopolitike, njësoj siç bënë nafta dhe qymyri në shekujt e kaluar.

Rrjetet e informacionit po përshpejtojnë propagandën dhe fragmentimin shoqëror, ashtu siç luajti rolin e vet shtypi gjatë revolucioneve ideologjike të së kaluarës. Me pak fjalë, nuk jemi thjesht dëshmitarë të ndryshimit; po përjetojmë një riorganizim të plotë të sistemeve.

Si? Duke kaluar nga një ekonomi materiale në një ekonomi të bazuar në dije, dhe duke reaguar me shpejtësi ndaj sfidave si ndryshimet klimatike, modelet e reja të globalizimit dhe teknologjitë tronditëse.

Dhe kjo është sfida më e madhe sot e shkencave sociale, të cilat nuk mund të analizojnë shoqërinë me konceptet e një moderniteti solid, por të ujshëm, të ndryshueshëm do të thoshte Zigmund Bauman. Sot shkencat sociale duhet jo vetëm të shpjegojnë shoqërinë por **të mbrojnë dhe ripërkufizojnë rolin njerëzor në një botë që po udhëhiqet nga algoritmet.**

Po parashtroj disa pyetje të parehatshme, jo për t'ju marrë në provim, as për t'iu përgjigjur këtu, por për t'i menduar pas kësaj fjale. Janë pyetje që më mendojnë dhe besoj se duhet të jenë thelbësore në çdo program serioz politik, ekonomik, zgjedhor.

E para: inteligjënca artificiale, nuk është një xhungël kabllosh: është një produkt thellësisht socialkulturore, sepse ka marre formën e vlerave, etikës, paragjykimeve, ideologjive dhe strukturave të pushtetit që përkrahin krijuesit e saj.

-Kur IA analizon sjellje dhe parashikon trende më shpejt se njeriu, çfarë mekanizmash ka në dorë një sociolog, antropolog, për të identifikuar, matur, paragjykimet dhe diskriminimjn algoritmik psh të modelit IA?
Si i ndryshon IA raportet mes pushtetit, institucioneve dhe qytetarëve?

Forumi Ekonomik Botëror ka publikuar listën e profesioneve që do të dominojnë tregun e punës në vitin 2030, duke lënë jashtë shumë profesione që ende përbëjnë shumicën e tregut të punës në Ballkan. Në 2030, me shumë gjasa nuk do të ketë më nevojë për asistentë administrativë, sekretarë, arshivistë, nënpunës ligjorë, shoferë, punonjës postare, etj.

Gati të gjitha profesionet e reja do të bazohen në teknologjinë e informacionit.

Këtë e dimë tashmë. Por pyetja ime tjetër është:

A jemi të përgatitur për këtë përmbysje në tregun e punës, ku aftësitë, jo titujt apo diplomat, po bëhen monedha kryesore e ekonomisë moderne?

Për shembull:

- Vetëm 2.6% e të punësuarve në rajon janë specialistë IT; Me të vërtetë sektori i ICT është një nga industritë më në rritje në MV, por mbështetja dhe financimi për kërkim dhe inovacion si dhe mbështetja e subvencionet për të krijuar lidhje të qëndrueshme biznes akademi, mungojnë.
- Shpenzimet për kërkim dhe inovacion në rajon përbëjnë vetëm 0.4% të PBB-së. Lista është e gjatë.

Pyetja e tretë është:

Në cilën “të ardhme” duam të hyjmë, jo si mysafirë, por si të barabartë?

Këtu, një pjesë e temës së konferencës më tingëllon dhimbshëm e njohur: epoka e integritit evropian.

Të jemi të singjertë. Kjo “epokë” ka zgjatur më shumë se disa perandori. Për Ballkanin, nuk është më një fazë kalimtare. Është kthyer gati në një gjendje statike në një botë që ndryshon çdo ditë.

Ukraina po lufton një luftë që është edhe për të ardhmen e Europës.

SHBA dhe BE po hyjnë në një luftë tregtare.

Jugu Global po krijon aleanca të reja.

Dhe Ballkani Perëndimor? Rrezikon të mbetet një periferi pasive në një epokë të rreshtimeve aktive.

Cfarë lloj zgjerimi apo partneriteti strategjik duam të ndërtojmë?

Çfarë përfitimesh praktike, bashkëpunim më i fortë në mbrojtje, siguri energjetike, qëndrueshmëri kibernetike, mund të realizojmë përmes integritetit më të thellë me tregun e përbashkët evropian?

Dhe më urgjentja: cilat janë rreziqet nëse ky proces ngec, duke e lënë rajonin tonë të cënueshëm dhe të pasigurt në një kohë kur nevojiten qartësi dhe unitet?

Ju e njihni mirë këtë kalvar. Nga 2004 kanë kaluar 21 vjet.

Dikur, Maqedonia e Veriut ishte historia e suksesit të Ballkanit. Ishte vendi që kishte kurajën të marrë vendime të mëdha, të hapë rrugë drejt NATO-s dhe BE-së, dhe të japë shembull stabiliteti në një rajon të trazuar.

Por sot, pavarësisht gjithë përpjekjeve, vendi ka ngecur. Prosesi i integritetit është kthyer në një rrugë të gjatë me kthesa politike, bllokime të reja dhe zhgënjim.

Nuk është faji i qytetarëve. Është rezultat i një lodhjeje europiane, i një kokëfortësie nacionaliste, realiteti ku interesat kombëtare të disa shteteve anëtare shpesh peshojnë më shumë se vlerat e përbashkëta europiane.

Shqiptarët në Maqedoninë e Veriut kanë treguar në mënyrë të vazhdueshme se janë faktor stabiliteti, konstruktiviteti dhe orientimi euroatlantik. Gjate 6 viteve që drejtova Këshillin e Bashkëpunimit Rajonal, Maqedonia e Veriut ka qene dhe mbetet një nga vendet me aktive në mbështetje të agjendave progressive rajonale. Për herë të parë pas dekadash, ne nisëm ta ndërtonim bashkëpunimin jo mbi kujtimet e luftës, por mbi logjikën e zhvillimit.

Procesi i Berlinit u bë platforma që na bashkoi dhe aty, së bashku me liderët e rajonit, nënshkruam marrëveshje që kanë ndikuar drejtpërdrejt në jetën e qytetarëve:

- **“Roam like at home”**, që hoqi tarifat roaming mes vendeve të Ballkanit
Perëndimor – një shembull konkret se si bashkëpunimi i mirëbesuar sjell përfitime të prekshme për qytetarët.
- **Marrëveshjet për njohjen e ndërsjellë të diplomave universitare** – një hap gjigant për lëvizjen e lirë të dijes dhe njerëzve.
- **Njohja e profesioneve**, që i mundëson mjekëve, inxhinierëve, juristëve të punojnë përtej kufijve pa pengesa burokratike.

Këto nuk janë vetëm dokumente. Janë ura të reja. Janë themeli i një tregu të përbashkët rajonal që përgatit terrenin për integrimin europian të plotë. Sepse, le ta themi hapur: Europa nuk do të na pranojë si individë të ndarë, por si rajon që funksionon bashkë.

Të nderuar miq,

E ardhmja e rajonit nuk mund të mbetet peng i brezave që e shohin bashkëpunimin si kompromis të turpshëm. As i atyre që fusin shkopinjtë nën rrota bashkëkombësve si për të na rikujtuar gjithmonë Faik Konicën kur thoshte: "kush nuk e do përparimin e merr kufirin e mendjes së tij për kufirin e botës".

Ky brez i ri duhet të jetë brezi që sheh mundësi tek kriza dhe mendon për zgjidhje e jo hamkarrje. Dhe ky brez jeni ju, studentët e këtij universiteti, djemtë dhe vajzat që e shohin Europën jo si ëndërr të largët, por si horizont natyror të identitetit tuaj. E di, shumë prej jush **60% e të rinjve** në Maqedoni të Veriut, si në të gjithë rajonin, mendoni të largoheni.

Si prind, uroj që secili prej jush të gjejë vendin që meriton kudoqoftë në botën e madhe e të lirë. Shpopullimi nuk është triumf i lirisë së lëvizjes. E di edhe se ju që doni të largoheni nuk e bëni këtë se nuk doni vendin tuaj, por sepse nuk gjeni dot kuptim brenda tij. Nuk është ikja mosbesim ndaj lirisë, por ndaj sistemit që nuk jep garanci se puna, talenti apo përpjekja shpërblehen ndershmërisht.

Dhe ky është problem më i madh, fatkeqësisht ende i pamarrë seriozisht në vendet tona.

Nëse duam të jemi pjesë e Europës, duhet të mendojmë për oksigjenin intelektual të vendeve tona. Cdo reformë, cdo politikë, është akt i brezit të ri. Dhe për këtë nuk mjafton diploma. Duhet hapësira për të dështuar pa u gjykuar, për të pyetur pa frikë, për të sfiduar mendimin e mykur pa u ndëshkuar.

Kudo. Në universitetet, administrata, familje.

Në fund, bashkëpunimi rajonal dhe integrimi europian janë dy anë të së njëjtës medalje: një rajon i bashkuar në funksion, por i pasur në identitet dhe duke pranuar lirinë e tjetrit.

Nuk duhet të jesh shumë i zgjuar për të kuptuar nevojën urgjente të Evropës për **investime strategjike** në **teknologji, zbutjen e ndryshimeve klimatike, demografike, mbrojtje dhe siguri** në të gjithë kontinentin. Dhe kur them kontinentin e shoh Ballkanin Perëndimor sic është gjeografia e harta, pjesë të Europës.

Bashkimi Evropian po hyn në një periudhë **vendimesh dhe kompromisesh të mëdha**. Baza e fuqisë që mbështeti të kaluarën, **vlerat dhe tregjet**, tashmë është e pamjaftueshme. Europa duhet të rilindë si **fuqi që ndërton**, jo si fuqi që rregullon. Duhet të rikthejë besimin e qytetarëve të saj duke treguar se demokracia mund të jetë efikase, humane dhe e fortë njëkohësisht. Dhe Ballkani, pjesë e kësaj harte, duhet të mos presë vetëm, por të marrë pjesë aktive në këtë ndryshim, duke ndërtuar institucione të forta, ekonomi të qëndrueshme dhe shoqëri të drejta.

Urime e punë të mbarë, stafit akademik dhe studenteve të Universitetit të Tetovës në misionin kuptimplotë, të mbrojtjes së lirisë më mirë se sa një ushtri!